



UDHËZUES PRAKTIK PËR OJF-të

NGRITJA E **SIPËRMARRJEVE SOCIALE** NË
PRONA TË KONFISKUARA NGA KRIMI I
ORGANIZUAR



U.S. EMBASSY
Tirana, Albania

UDHËZUES PRAKTIK PËR OJF-të

NGRITJA E
SIPËRMARRJEVE SOCIALE
NË PRONA TË
KONFISKUARA NGA KRIMI
I ORGANIZUAR

Udhëzues praktik për organizatat e shoqërisë civile për ngritjen e sipërmarrjeve sociale në prona të konfiskuara nga krimi i organizuar.

©2020, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Ky botim mundësohet me mbështetjen financiare të Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Grafika & Faqosja:

Maris Selamaj

Përmbajtja

03	1. HYRJE.
04	2. RIPËRDORIMI SOCIAL I PRONAVE TË KONFISKUARA NGA KRIMI I ORGANIZUAR
05	3. MUNDËSITË E KRIJIMIT TË SIPËRMARRJEVE SOCIALE NË PRONA TË KONFISKUARA NGA KRIMI I ORGANIZUAR NË SHQIPËRI
08	4. HAPAT PËR KRIJIMIN E NJË SIPËRMARRJE SOCIALE NË PRONAT E KONFISKUARA NË SHQIPËRI
10	Hapi 1: Njohja me Bazën Ligjore dhe Institucionet Përgjegjëse për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
12	Hapi 2: Diskutimi dhe zhvillimi i idesë brenda organizatës
13	Hapi 3: Vendosija e kontakteve me AAPSK për të diskutuar mbi idenë dhe për t'u njohur me pronat e konfiskuara që janë nën administrimin e Agjencisë
14	Hapi 4: Organizimi i vizitave në pronën/at e përzgjedhur/a, për të identifikuar atë që është më e përshtatshme për idenë tuaj
14	Hapi 5: Sigurimi i mbështetjes dhe përkrahjes nga aktorët lokalë në territorin ku ndodhet prona e përzgjedhur në bashkëpunim me Agjencinë
15	Hapi 6: Përgatitja e projekt propozimit të plotë
16	Hapi 7: Paraqitja e projektit dhe kërkesës zyrtare pranë Agjencisë për marrjen në përdorim të pronës së konfiskuar
16	Hapi 8. Firmosja e kontratës me Agjencinë
17	Hapi 9. Ngritja e sipërmarrjes sociale
18	5. SIPËRMARRJET E PARA SOCIALE TË NGRITURA NË SHQIPËRI NË PRONA TE KONFISKUARA NGA KRIMI I ORGANIZUAR
18	KeBuono
18	KinFolk Coffee Library
18	Garazhi Social i Artizanatit
19	6. SHEMBUJ TË SIPËRMARRJEVE SOCIALE TË NGRITURA NË PRONA TË KONFISKUARA NGA KRIMI I ORGANIZUAR NË ITALI
19	LA FORZA DEL SILENZIO dhe LFS GLOBAL CARE
19	N.C.O.
19	Le Terre di Don Peppe Diana
19	Made in Castel Volturno
A.1	Shtojca A: Forma e projekt propozimit
B.1	Shtojca B: Modeli i planit të biznesit për Sipërmarrjet Sociale
C.1	Shtojca C: Kontratë huapërdorje
D.1	Shtojca D: Lista e pronave të konfiskuara nga AAPSK deri në muajin mars 2020

1. HYRJE

Në vitin 2009, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 10192 Datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafiqeve dhe korrupsionit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i cili parashikon dhënien në huapërdorje të pasurive të konfiskuara nga krimi i organizuar për qëllime sociale. Në zbatim të këtij ligji, VKM Nr. 632, datë 23.7.2010 “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, të mënyrave dhe të procedurave të dhënies në përdorim e të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, parashikon se organizatat e shoqërisë civile janë ndër subjektet që përfitojnë nga dhënia në përdorim e këtyre pasurive, duke njohur vlerën e tyre si aktorë të rëndësishëm në trajtimin e problemeve sociale dhe zhvillimin e ekonomisë lokale.

Praktika ndërkombëtare ka treguar se ripërdorimi i pasurive të konfiskuara për qëllime sociale në luftën ndaj ekonomisë së paligjshme ka sjellë impakt pozitiv në jetën e komuniteteve, në përfshirjen e popullsisë në projekte sociale dhe kulturore, në promovimin e punës vullnetare, në krijimin e partneriteteve midis institucioneve publike, private dhe OJF-ve, në krijimin e vendeve të punës, në vet-qëndrueshmërinë nëpërmjet aktivitetit ekonomik me qëllim social, etj.

Krijimi i sipërmarrjeve sociale në prona të konfiskuara nga krimi i organizuar ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e mirëqenies ekonomike të komunitetit dhe zhvillimit të territorit nëpërmjet prodhimit të produkteve dhe të mirave si dhe krijimit të mundësive për punësim, përveç atyre që krijohen nga sektori privat dhe publik. Për më tepër, kjo praktikë prodhon efekte indirekte në prodhimin, nxitjen dhe ruajtjen e komponentëve të kapitalit social si besimi ndaj institucioneve dhe respektimi i ligjit, si dhe nxit pjesëmarrjen aktive në aktivitetet sociale të komunitetit. Këto elemente përmirësojnë cilësinë e jetës së individëve dhe në të njëjtën kohë kontribuojnë në krijimin e rrugëve të reja drejt ligjshmërisë dhe respektimit të ligjit.

Bazuar në eksperiencat e suksesshme në vendet e BE, veçanërisht në modelin Italian të ripërdorimit të pronave të konfiskuara nga mafia për qëllime sociale, si dhe në mundësitë e ofruara nga kuadri ligjor ekzistues në Shqipëri, në vitin 2016 Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim ndërmori iniciativën e parë në vend dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor për ngritjen e sipërmarrjeve sociale në prona të konfiskuara nga krimi i organizuar. Me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian filloi zbatimin e C.A.U.S.E – Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Sipërmarrje Sociale, si rezultat i të cilit sot kemi tre sipërmarrjet e para sociale të ngritura në tre prona të konfiskuara nga krimi i organizuar në Durrës, Fier dhe Sarandë.

Sfidat, mësimet e nxjerra dhe rezultatet e kësaj iniciative prezantohen në këtë udhëzues, i cili nëpërmjet një qasje praktike dhe konkrete synon t’u vijë në ndihmë organizatave të shoqërisë civile në përpjekjet e tyre për zhvillimin e një sipërmarrje sociale në një pronë të konfiskuar^[1] nga krimi i organizuar.

[1] Pasuritë e sequestruara dhe të konfiskuara ndahen në disa kategori si më poshtë:

- Pasuri të paluajtshme ku përfshihen: ndërtesa, njësi tregtare, apartamente, truall, garazhe/bodrome, tokë bujqësore/kullota/etj.
- Llogari bankare
- Pasuri të luajtshme ku përfshihen automjete, etj.
- Biznese

Në fokus të këtij udhëzuesi janë pasuritë që përfshihen në kategorinë e parë: Pasuri të paluajtshme me status “të konfiskuara”, të cilave u referohemi me termin **“pronë e konfiskuar”**.

2. *RIPËRDORIMI SOCIAL* I PRONAVE TË KONFISKUARA NGA KRIMI I ORGANIZUAR

Pronat e konfiskuara nga krimi i organizuar janë një burim i rëndësishëm për territorin ku ndodhen. Rikthimi në komunitet i pronave të përfituara në mënyrë të paligjshme, për t'u përdorur për qëllime sociale, është një strategji efektive në luftën e përbashkët ndaj krimit të organizuar. Menaxhimi i këtyre pronave nga organizatat e shoqërisë civile dhe mundësia për t'i shndërruar ato në mjedise ku zhvillohen njëkohësisht aktivitete të nevojshme ekonomike dhe sociale, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në mirëqënien e komunitetit nëpërmjet prodhimit të të mirave dhe shërbimeve dhe krijimit të mundësive për punësim. Kur institucionet dhe shoqëria civile i përdorin këto prona në mënyrë efektive për qëllime sociale duke ofruar alternativa të ligjshme zhvillimi kundrejt praktikave dhe kulturës së krimit të organizuar, ky është një sinjal i humbjes së kontrollit dhe prestigjit të eksponentëve kriminalë në territoret që ata i pretendojnë si të tyre dhe një provë e vërtetë e ndryshimit që po ndodh në një territor të krimit të organizuar.

Direktiva e Bashkimit Evropian 2014/42/EU i inkurajon vendet anëtare të BE “të konsiderojnë marrjen e masave që lejojnë përdorimin e pronave të konfiskuara për interes publik apo qëllime sociale”. Praktika ka treguar që në vendet e prekura nga probleme serioze që lidhen me krimin e organizuar, ri-përdorimi i aseteve të konfiskuara në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile ka rezultuar një mjet i vlefshëm për të rikonfirmuar forcën e ligjit dhe për të treguar se reagimi qytetar në luftën kundër krimit të organizuar është i mundur.

Ri-përdorimi i qëndrueshëm i pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar duke i shndërruar në sipërmarrje sociale konsiderohet si një metodë efektive për të luftuar krimin e organizuar dhe për zhvillimin social ekonomik të komunitetit, falë tre (3) dimensioneve që e karakterizojnë një sipërmarrje të tillë. Së pari është dimensioni politik dhe mesazhi që këto sipërmarrje sociale përçojnë në komunitetet lokale për mposhtjen e frikës nga sundimi i krimit të organizuar. Së dyti, është dimensioni social - sipërmarrjet sociale angazhojnë personat të cilët kanë qenë viktimat të krimit të organizuar apo persona të cilët i përkasin grupeve të disavantazuara dhe janë në risk për t'u prekur nga krimi i organizuar duke u dhënë atyre një mundësi të ri-integrohen në komunitetet përkatëse.

Së treti është dimensioni ekonomik - sipërmarrjet sociale në pronat e konfiskuara ashtu si çdo sipërmarrje tjetër gjenerojnë vende pune dhe kanë për qëllim maksimizimin e fitimit, i cili do të riinvestohet dhe do të shkojë në funksion të misionit social të sipërmarrjes.

Sipërmarrja sociale është një lloj iniciative sipërmarrjeje që synon të trajtojë një problem social duke sjellë një transformim në komunitet, dhe që është në gjendje të ofrojë zgjidhje origjinale për probleme të ndryshme sociale duke zbatuar një model biznesi. Edhe pse fitimi është një prej aspekteve të këtij koncepti, ai nuk është qëllimi i vetëm dhe primar i sipërmarrjes.

Një sipërmarrje sociale është një organizatë e drejtuar nga fitimi dhe qëllimi, në të cilën praktika e të bërit biznes dhe qëllimet sociale funksionojnë në të njëjtën kohë. Sipërmarrja sociale karakterizohet nga një nivel i lartë inovacioni dhe mund të përballojë sfida dhe të kapërcejë pengesa që nuk adresohen mjaftueshëm nga biznesi tradicional apo nga një organizatë jofitimprurëse.

Sipërmarrjet sociale ofrojnë shërbime që promovojnë kohezionin social duke përdorur burimet njerëzore dhe financiare për të mirën e komunitetit ose qytetarëve të disavantazuar (psh. të mitur, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara, të papunë, persona me varësi nga droga, ish të burgosur, persona të trafikuar, etj.). Integrimi i tyre është një ndër atributet më të rëndësishme të sipërmarrjes sociale dhe jep një kontribut të rëndësishëm për komunitetin duke luftuar përjashtimin social dhe duke inkurajuar zhvillimin lokal me krijimin e vendeve të punës (Borzaga C & Defourny J., 2001). Përtej funksioneve të mësipërme, një sipërmarrje sociale e ngritur në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar parandalon mundësinë e blerjes së pronës nga organizata kriminale duke thyer kështu rrethin vicioz që prodhon mungesën e besimit të njerëzve në drejtësi dhe në institucione dhe favorizon zhvillimin ekonomik të territorit. Marrja e këtyre pronave nga krimi i organizuar dhe rikthimi i tyre komunitetit që i janë “vjedhur” nëpërmjet terrorit dhe krimit dhe i cili ka vuajtur nga veprimtaria kriminale e ish-pronarëve të tyre, përbën një mjet politik që bën të mundur rikthimin dhe përforcimin e besimit tek institucionet.

Për vetë misionin e rëndësishëm që kanë këto sipërmarrje, ato duhet të provojnë që janë modele të suksesshme dhe të kthehen në zgjidhje të qëndrueshme për komunitetet në të cilat ndodhen. Në rast të kundërt, një dështim i tyre do të përçonte një mesazh negativ në luftën ndaj krimit të organizuar.

3. MUNDËSITË E KRIJIMIT TË *SIPËRMARRJEVE SOCIALE* NË PRONA TË KONFISKUARA NGA KRIMI I ORGANIZUAR NË SHQIPËRI

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), krijuar në zbatim të Ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” ndryshuar me ligjin Nr. 10 192 date 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, është institucioni shtetëror përgjegjës për administrimin dhe/ose përdorimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga krimi i organizuar. AAPSK është një institucion në varësi të Ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe e ushtron veprimtarinë e saj bazuar në Ligjin Nr. 34/2019, “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara”, ndryshuar me Ligjin Nr. 19/2020 “Për Disa Shtesa Dhe Ndryshime Në Ligjin Nr. 34/2019”, “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara. Një ndër risitë më të rëndësishme që sjell ligji Nr. 34/2019 është përfshirja në qëllimin e tij e konceptit **“rikthimi në komunitet i pasurive të fitura në mënyrë të paligjshme”**, i cili reflekton një ndryshim rrënjësor në mendësinë dhe përqasjen e shtetit ndaj këtyre pronave, duke theksuar ripërdorimin e tyre.

Vendimi Nr. 632, Datë 23.7.2010 “Për Përcaktimin e Kritereve të Vlerësimit, Të Mënyrave dhe të Procedurave të Dhënies në Përdorim e të Tjetërsimit të Pasurive të Konfiskuara”, në zbatim të Ligjit Nr. 10 192, Datë 3.12.2009, i mundësoi AAPSK dhënien në përdorim të pasurive të konfiskuara organizatave jofitimprurëse.

Deri në vitin 2016, kur filloi zbatimi i CAUSE – Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Sipërmarrje Sociale, kjo ka qenë një mundësi e pashfrytëzuar nga AAPSK dhe nga organizatat e shoqërisë civile, për shkak të disa faktorëve, si më poshtë:

- Mungesa e kuptueshmërisë nga ana e institucioneve politikëbërëse dhe ligjzbatuese mbi rëndësinë dhe përfitimet që sjell për komunitetin ripërdorimi për qëllime sociale nga OJF-të i pasurive të konfiskuara, e për rrjedhojë një mungesë totale promovimi e kësaj mundësie. Për këtë arsye, AAPSK ishte një institucion i panjohur nga publiku dhe sektori jo-fitimprurës.
- Mungesa e besimit dhe guximit nga ana e institucioneve shtetërore për të ndërmarrë iniciativë të tilla, duke i konsideruar si të pamundura për t’u realizuar.
- Kapacitete të pamjaftueshme njerëzore edhe teknike të AAPSK si dhe numri i ulët i pronave të konfiskuara nën administrimin e saj.
- Mungesa e informacionit nga OJF-të mbi ekzistencën e kësaj mundësie, që për rrjedhojë nuk solli kërkesë nga ana e tyre për përdorimin e këtyre pronave.
- Hezitimi dhe frika nga ana e OJF-ve që lidhen me rrezikshmërinë që mund të paraqesë prejardhja kriminale e këtyre pronave, shoqëruar me mungesën e besimit dhe forcën e pamjaftueshme të institucioneve shtetërore për të mbështetur organizatat e shoqërisë civile në këto iniciativë.

Për rrjedhojë, fillimi i zbatimit të CAUSE e gjeti AAPSK me vakum të një praktike dhe procedure standarte formale mbi procesin që duhet të ndjekin organizatat e shoqërisë civile për marrjen në përdorim dhe për shfrytëzimin e një prone të konfiskuar nga krimi i organizuar.


Sot, me një kuadër ligjor të përmirësuar në drejtim të ripërdorimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, përpjekjet e shtuara në luftën ndaj krimit të organizuar, një numër në rritje të pronave të konfiskuara[2], kapacitete të shtuara dhe të përmirësuara, si dhe një kuptim më të mirë nga ana e strukturave shtetërore përgjegjëse të punës dhe kontributit të organizatave të shoqërisë civile në rikthimin e pronave të konfiskuara në komunitet, ndërgjegjësim më të madh të OJF-ve, dhe shembullin e tre sipërmarrjeve[3] të para sociale në pronat e konfiskuara nga krimi i organizuar, ekziston një potencial më i madh për shfrytëzimin e kësaj mundësie.

Praktika e ndjekur nga Partnerët Shqipëri për krijimin e tre sipërmarrjeve të para sociale në pronat e konfiskuara nga krimi i organizuar në vend, në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues dhe në bashkëpunim me AAPSK, e prezantuar më poshtë në këtë Udhëzues, shërben jo vetëm për krijimin e një procedure që mund të ndiqet në vazhdim nga organizatat e tjera të interesuara, por edhe për krijimin e një modeli të bashkëpunimit shtet-organizata të shoqërisë civile për ri-përdorimin e qëndrueshëm të pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar, që i shërben mbrojtjes dhe rehabilitimit të viktimave të krimit të organizuar, zhvillimit social ekonomik të komunitetit, dhe sundimit të ligjit dhe të drejtësisë.

[2] Shtojca D: Lista e raportuar me pronat e konfiskuara nga AAPSK në mars 2020.


[3] KeBuono pasiçeri sociale në Fier, Kafe Librari KINFOLK në Durrës, Garazhi Social i Artizanatit në Sarandë.

Pasuri të konfiskuara deri në mars 2020



Harta e shpërndarjes së pasurive të paluajtshme (prona të konfiskuara) nën administrimin e AAPSK në mars 2020*

	APARTAMENT	TRUALL	GARAZHE	NJËSI TREGTARE	TOKË BUJOËSORE & KULLOTA
LEZHË	×	×	2	×	×
DURRËS	1	2	×	2	4
TIRANË	2	×	×	2	12
ELBASAN	×	×	1	×	×
LUSHNJE	×	2	×	1	×
FIER	×	×	×	2	1
VLORË	2	×	×	2	×
SARANDË	×	×	×	×	1



4. *HAPAT* PËR KRIJIMIN E NJË SIPËRMARRJE SOCIALE NË PRONAT E KONFISKUARA NË SHQIPËRI

Bazuar në VKM, Nr. 632[4] “Institucionet e zbatimit të ligjit, njësitë e qeverisjes vendore, si dhe **organizatat jofitimprurëse**, për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të krimit të organizuar, janë subjektet që përfitojnë nga dhënia në përdorim” e pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar.

Po sipas kësaj VKM, “*për procedurën e dhënies në përdorim të pasurive të konfiskuara, përfituesi duhet të paraqesë një kërkesë, ku të përcaktohet shprehja e interesit të motivuar e të argumentuar*”.

Në vijim, trajtohen të gjithë hapat që duhet të ndjekë një OJF, në mënyrë që të marrë në përdorim një pronë të konfiskuar e për ta kthyer atë në një sipërmarrje sociale që do të mundësonte “përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të pasurive të konfiskuara”, në përputhje me qëllimin e Ligjit Nr. 19/2020[5].

[4] VENDIM Nr. 632, datë 23.7.2010 PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT, TË MËNYRAVE DHE TË PROCEDURAVE TË DHËNIES NË PËRDORIM E TË TJETËRSIMIT TË PASURIVE TË KONFISKUARA, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 10 192, DATË 3.12.2009.

[5] LIGJ Nr. 19/2020 PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 34/2019, “PËR ADMINISTRIMIN E PASURIVE TË SEKUESTRUARA E TË KONFISKUARA

1

HAPI

Njohja me Bazën Ligjore dhe Institucionet Përgjegjëse për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

2

HAPI

Diskutimi dhe zhvillimi i idesë brenda organizatës

3

HAPI

Vendosja e kontakteve me AAPSK për të diskutuar mbi idenë dhe për t'u njohur me pronat e konfiskuara që janë nën administrimin e Agjencisë

4

HAPI

Organizimi i vizitave në pronën/at e përzgjedhur/a, për të identifikuar atë që është më e përshtatshme për idenë tuaj

5

HAPI

Sigurimi i mbështetjes dhe përkrahjes nga aktorët lokalë në territorin ku ndodhet prona e përzgjedhur në bashkëpunim me Agjencinë

6

HAPI

Përgatitja e projekt propozimit të plotë

7

HAPI

Paraqitja e projektit dhe kërkesës zyrtare pranë Agjencisë për marrjen në përdorim të pronës së konfiskuar

8

HAPI

Firmosja e kontratës me Agjencinë

9

HAPI

Ngritja e sipërmarrjes sociale

Hapi 1: Njohja me Bazën Ligjore dhe Institucionet Përgjegjëse për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Çdo organizatë që synon të zbatojë një projekt në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar duhet të ketë një njohje të mirë të kuadrit ligjor dhe strukturave përgjegjëse, si më poshtë:

Kuadri Ligjor:

- *Ligj Nr. 10 192, datë 3.12.2009 Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, ndryshuar me ligjin nr. 24/2014*
- *Ligj Nr. 85/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 192 Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, të ndryshuar*
- *Ligj Nr. 34/2019, “Për Administrimin E Pasurive Të Sekuestruara E Të Konfiskuara”*
- *Ligj Nr. 19/2020 Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 34/2019, “Për Administrimin e Pasurive të sekuestruara e të Konfiskuara”*
- *Vendim Nr. 632, Datë 23.7.2010 Për Përcaktimin e Kritereve të Vlerësimit, Të Mënyrave dhe të Procedurave të Dhënies në Përdorim e të Tjetërsimit të Pasurive të Konfiskuara, në zbatim të Ligjit Nr. 10 192, Datë 3.12.2009.*

Strukturat përgjegjëse:

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është institucioni i vetëm në nivel qendror përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike. Kompetencat dhe përgjegjësitë kryesore të Agjencisë lidhen me marrjen në dorëzim të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara; administrimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, nëpërmjet administrimit të drejtpërdrejtë apo të të tretëve; përgatitjen e dokumentacionit të plotë për tjetërsimin apo dhënien në përgjegjësi administrimi të pasurive të konfiskuara, mbikëqyrjen e veprimtarisë së përfituesit nga fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit, të cilit i është dhënë në përdorim, përgjegjësi administrimi apo huapërdorje e një pasurie të konfiskuar, nëse përdorimi i pasurisë është apo jo në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike; etj.

Përsa i përket strukturës, Agjencia drejtohet dhe përfaqësohet nga Kryeadministratori, i cili drejton dhe organizon veprimtarinë e Agjencisë; mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë që kryhet për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara; negocion dhe lidh kontratat e qirasë, huapërdorjes dhe enfilezës për pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara, etj.

Kryeadministratori cakton dhe ka në varësi të tij:

- Administratorët e pasurive të sekuestruara
- Administratorët e pasurive të bllokuara e të sekuestruara me urdhër administrativ
- Administratorët e pasurive të konfiskuara, kompetencat dhe përgjegjësitë e të cilëve përcaktohen në ligjin për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

Për mbikëqyrjen e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga Agjencia, si dhe për marrjen e vendimeve për destinacionin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara ngrihet dhe funksionon Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar, sipas përcaktimeve të nenit 35, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar. Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar vendos për destinimin e pasurive, si dhe për përdorimin efektiv të të ardhurave brenda buxhetit të shtetit. Komiteti përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, të propozuar respektivisht nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministri përgjegjës për çështjet e ekonomisë, ministri përgjegjës për çështjet e drejtësisë, ministri përgjegjës për çështjet sociale, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Njësia e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Anëtar i propozuar nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike është kryetar i komitetit. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ushtron funksionin e sekretariatit teknik pranë komitetit.

Si mund të përfitojnë OSHC-të nga pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara subjekt i kuadrit ligjor të sipërpërmendur dhe të administruara nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara?

Dy janë mënyrat nëpërmjet të cilave organizatat e shoqërisë civile mund të përfitojnë nga pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara:

1. Marrja në përdorim e pasurive të konfiskuara, subjekt i këtij Udhëzuesi.
2. Financim të projekteve nëpërmjet Fondit të Posaçëm për parandalimin e kriminalitetit.

Fondi i Posaçëm për parandalimin e kriminalitetit[6]

Të ardhurat e përfituara nga zbatimi i ligjit Nr. 10 192, datë 3.12.2009, shërbejnë për ngritjen e fondit të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor. Fondi i posaçëm është një zë më vete në buxhetin e Agjencisë dhe administrohet me vendim nga Komiteti. Fondi shërben për katër qëllime kryesore:

- a) *përmirësimin e funksionimit të drejtësisë penale, duke destinuar pasuritë në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike;*
- b) *përmirësimin e parandalimit të kryerjes së veprave penale, hetimeve paraprake penale të krimit të organizuar dhe zhvillimin e programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve e të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet e rendit publik;*
- c) *dhënien e ndihmës viktimave të krimit të organizuar, si dhe nxitjen e programeve sociale për këto kategori, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet sociale;*
- ç) *dëshmipërblimin e viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit në masën e përcaktuar me vendim gjyqësor;*
- d) *mbulimin e diferencave në vlerë që mund të krijohen nga administrimi i pasurive, të cilat me vendim gjyqësor i kthehen pronarit të pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.*

[6] Neni 37, LIGJ NR. 10 192, DATË 3.12.2009 PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT DHE KORRUPSIONIT NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË, I NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 24/2014 dhe LIGJ NR. 85/2020 PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.10 192, DATË 3.12.2009, “PËR PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKIMIT, KORRUPSIONIT DHE KRIMEVE TË TJERA NËPËRMJET MASAVE PARANDALUESE KUNDËR PASURISË”, TË NDRYSHUAR

Përfitues të financimit të projekteve për parandalimin e kriminalitetit janë: institucionet qendrore, njësitë e qeverisjes vendore ku ndodhen pasuritë e paluajtshme të konfiskuara, dhe organizatat jofitimprurëse, që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre rehabilitimin social, kulturor e shëndetësor të shtresave në nevojë, veçanërisht atyre të prekura apo të rrezikuara nga krimi, përfshirë organizatat dhe qendrat terapeutike, qendrat e riaftësimit dhe të kurimit të përdoruesve të substancave narkotike, si dhe qendrat e asistencës e të rehabilitimit të viktimave të trafikut të genieve njerëzore, që, në tri vitet e fundit nga paraqitja e kërkesës, zhvillojnë veprimtari të tilla.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është përgjegjëse për mbledhjen e kërkesave për financimin e projekteve, verifikimin dhe përgatitjen e dokumentacionit për Komitetin Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar, si dhe ndjekjen e zbatimit të tyre. Komiteti, me vendim, përcakton financimin e projektit dhe mënyrat e përdorimit të fondit të vënë në dispozicion të kërkuarit.

E RËNDËSISHME!

Kuadri ligjor është subjekt ndryshimi dhe përmirësimi, prandaj duhet që organizatat të jenë vazhdimisht të informuara rreth këtyre ndryshimeve. Kërkimi për ndryshime të tilla mund të bëhet online në faqen e Qendrës së Botimeve Zyrtare, ku pasqyrohen të gjitha ligjet, vendimet e qeverisë dhe institucioneve të tjera që publikohen në Fletoren Zyrtare.

Hapi 2: Diskutimi dhe zhvillimi i idesë brenda organizatës

Para se të fillojë procesin për përfitimin e një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar, organizata duhet të këtë një ide lidhur me aktivitetin që do të zhvillojë në pronën e konfiskuar, grupin e synuar dhe përfituesit primarë nga ky aktivitet, si dhe lidhjen midis aktivitetit dhe përcaktimit në ligjin për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit. Ideja mund të lidhet me vazhdimësinë e punës së organizatës duke u zhvendosur apo duke e shtrirë aktivitetin e saj në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar, të cilën mund ta marrë në përdorim pa pagesë, apo mund të jetë një ide e re që do të fillojë rishtazi në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar.

Ideja duhet të jetë në formën e një sipërmarrje sociale, e cila duhet të përmbushë një mision social, në përputhje me qëllimin dhe veprimtarinë e organizatës, si dhe të përcaktimeve në kuadrin ligjor që rregullon përdorimin e pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar dhe do të gjenerojë të ardhura që do të mundësojnë qëndrueshmërinë e aktivitetit për një periudhë afatgjatë. Sipërmarrja sociale në një pronë të konfiskuar dhe ekonomia që ajo gjeneron duhet të karakterizohen nga dëshira për të kontribuar në transformimin e një territori të uzurpuar dikur nga organizatat kriminale. Në qendër të idesë duhet të jetë kthimi mbrapsht i këtyre pronave te komuniteti, te njerëzit apo kategoritë që kanë qënë më shumë të prekur nga aktiviteti kriminal i tyre.

Si mund të realizohet kjo?

Shumica e sipërmarrësve socialë frymëzohen nga diçka. Ju mund të frymëzoheni nga një çështje sociale përmes përvojës suaj, por çështja që ju zgjidhni duhet të jetë e rëndësishme edhe për shumë të tjerë dhe jo vetëm për ju.

Edhe në rast se keni përvojë me çështjen sociale që kërkoni të trajtoni, ju duhet të kërkoni më tej. Ju duhet të keni një kuptim më të plotë mbi natyrën e përpjekjes suaj, kështu që duhet të merrni kohë për të bërë hulumtimin tuaj. Çështjet mbi të cilat duhet të hulumtoni janë:

- *Cili është problemi social të cilin do të targetoni?*
- *Cili është grupi juaj i synuar, apo përfituesit kryesorë?*
- *Cila është vlera e shtuar që dëshironi të sillni tek përfituesit tuaj?*
- *Cili është aktiviteti ekonomik që do të zhvilloni, i cili do të përdoret apo do të ndihmojë në integrimin e grupit të synuar?*
- *A ekziston një nevojë e vërtetë për këtë lloj aktiviteti?*
- *Cila është konkurrenca juaj dhe cili është pozicioni juaj në treg?*
- *Cilët janë klientë potencialë të shërbimeve/produkteve tuaja?*

Duke patur parasysh kompleksitetin që kërkon një iniciativë e tillë, e cila lidhet kryesisht me natyrën e pronës (e konfiskuar nga krimi i organizuar), ideja duhet të zhvillohet nëpërmjet një diskutimi të hapur dhe gjithëpërfshirës me të gjithë anëtarët e stafit të organizatës. Si pjesë e diskutimit duhet të trajtohen çështjet që lidhen me vlerat që sjell kjo iniciativë për organizatën dhe grupin/grupeve që u shërben, sfidat dhe risqet që ajo mbart në vetvete, bashkëpunimin me aktorë të tjerë, etj. Para se të vazhdohet me hapat e tjerë të procesit, të gjithë anëtarët e stafit duhet të bien dakord dhe të angazhohen në zbatimin e saj.

E RËNDËSISHME!

Organizata mund të kërkojë marrjen në përdorim të një prone të konfiskuar nga krimi i organizuar për të zhvendosur aktivitetin e saj aktual në një pronë të tillë, për të zgjeruar aktivitetin e saj në mjedise apo zona të tjera gjeografike, apo për të filluar një aktivitet krejtësisht të ri në përmbushje të misionit të saj.

Veprimtaria që do të zhvillohet në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar duhet t'i shërbejë komunitetit në tërësi, e në veçanti viktimave të krimit të organizuar apo personave dhe grupeve që janë në risk për t'u prekur nga aktiviteti kriminal, në përputhje me përcaktimin në VKM, Nr. 632.

Hulumtimi dhe analiza e tregut, studimet e fizibilitetit dhe analiza e industrisë ku do të fokusohet aktiviteti ekonomik mund t'ju ndihmojnë të përcaktoni potencialin e idesë suaj.

Hapi 3: Vendosja e kontakteve me AAPSK për të diskutuar mbi idenë dhe për t'u njohur me pronat e konfiskuara që janë nën administrimin e Agjencisë

Sikurse është përmendur më sipër, AAPSK është institucioni përgjegjës për administrimin dhe/ose përdorimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, në varësi të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike. Në përputhje me Ligjin 19/2020, nëpërmjet veprimtarisë së saj Agjencia duhet të sigurojë mirëadministrimin dhe përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga organet e drejtësisë ose pasurive të sekuestruara nga organet administrative, rikthimin në komunitet të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimin financiar të viktimave të kimit. Agjencia është përgjegjëse për ruajtjen, mirëmbajtjen, administrimin, menaxhimin dhe, kur është e mundur, shtimin e vlerës së pasurisë që nga çasti i marrjes dijeni për aktin e sekuestrimit e të konfiskimit dhe deri në atë të tjetërsimit ose të revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë.

Duke njohur qëllimin institucional që AAPSK duhet të përmbushë, rolin dhe funksionet e saj, bëhet e qartë se aspektet ekonomike, sociale, dhe financiare të idesë që do të prezantohet për ripërdorimin e pronave të konfiskuara janë elementë shumë të rëndësishëm për të.

AAPSK disponon listën me të gjitha pronat e sekuestruara dhe të konfiskuara të cilat janë nën administrimin e saj. Lista përmban informacion të detajuar lidhur me statusin e pronës (sekuestruar apo konfiskuar), vendndodhjen dhe adresën e pronës, llojin e pronës (psh. apartament, tokë, garazh, etj.), sipërfaqen e saj, etj. Ky informacion është shumë i rëndësishëm dhe ndihmon në marrjen e vendimit të duhur lidhur me pronën e përshtatshme për idenë tuaj. Bazuar në listën e pronave të mundshme për t'u marrë në përdorim, ju do të mund të rivlerësoni idenë tuaj për ta përshtatur atë me pronat në dispozicion.

Bazuar në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e saj dhe në listën e pronave të konfiskuara në dispozicion, Agjencia vlerëson vlefshmërinë e idesë së prezantuar dhe sugjeron pronën/pronat e përshtatshme për zbatimin e saj.

Si mund të viheni në kontakt me AAPSK?

Çdo organizatë e interesuar për të zhvilluar një sipërmarrje sociale në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar duhet të paraqesë një kërkesë ku të shprehë interesin për përdorimin e pronave të konfiskuara për qëllime sociale dhe të paraqitet fizikisht në zyrat e AAPSK, për të zhvilluar një takim me drejtuesit.

E RËNDËSISHME!

Organizata duhet të ketë të qartë idenë mbi bazën e të cilës do të shprehë interesin dhe të diskutojë me AAPSK mundësinë e zbatimit të saj në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar.

Organizata duhet të njohë mirë qëllimin institucional të AAPSK para se të prezantojë idenë për ripërdorimin social të një prone të konfiskuar dhe të sigurohet që në të janë të përfishirë të gjithë elementët që do të mundësojnë marrjen në shqyrtim nga ana e Agjencisë, në përmbushje të misionit të saj.

Edhe pse Agjencia mund të japë në ripërdorim edhe pronat e sekuestruara, me këtë status ato mund t'i rikthehen sërish ish-pronarit me vendim gjykate, prandaj rekomandohet që të konsideroni pronat e konfiskuara me vendim gjykate të formës së prerë, të cilat kanë kaluar në pronësi të shtetit!

Si një institucion në nivel qendror, AAPSK ka nën administrim prona të sekuestruara dhe të konfiskuara në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, prandaj kërkesa duhet të jetë shumë specifike, duhet të ketë të përcaktuar vendin ku organizata do të zhvillojë aktivitetin e saj në një pronë të konfiskuar.

Duhet të jeni të përgatitur që në territorin ku planifikoni të zhvilloni idenë tuaj, mund të mos ketë asnjë pronë të konfiskuar, mund të ketë një apo disa prona të tilla.

Për t'u njohur me listën e pronave të sekuestruara e të konfiskuara nën administrimin e Agjencisë, mund të paraqisni një kërkesë zyrtare, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 119/2014 Për të drejtën e informimit, dhe ta dërgoni pranë zyrave të Agjencisë.

Hapi 4: Organizimi i vizitave në pronën/at e përzgjedhur/a, për të identifikuar atë që është më e përshtatshme për idenë tuaj

Pasi është marrë informacioni mbi pronat e konfiskuara dhe është diskutuar me Agjencinë mbi pronën/at e mundshme që konsiderohet/n më të përshtatshme për ripërdorim bazuar në karakteristikat e pronës dhe natyrën e projektit që do të zhvillohet në të, duhet të zhvillohen vizita në terren për të parë nga afër pronën apo pronat e përzgjedhura paraprakisht për të vlerësuar fizibilitetin e idesë tuaj në të/to.

Vizita organizohet në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë, e cila cakton administratorin e pronës së konfiskuar për t'ju shoqëruar gjatë vizitës dhe për t'ju krijuar akses në pronë. Çdo pronë e sekuestruar apo e konfiskuar administrohet nga një administrator i caktuar nga Agjencia që koordinon, udhëzon, mbikëqyr dhe kontrollon zbatimin e procedurave ligjore për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, sipas fushës përkatëse që ai mbulon. Në bashkëpunim me administratorin e pronës së konfiskuar, koordinoni vizitën në pronën/pronat e përzgjedhur/a si të mundshme për realizimin e projektit tuaj.

Është e rëndësishme që në këtë vizitë të marrë pjesë ekipi kryesor i punës që do të jetë i përfshirë në përgatitjen dhe zbatimin e idesë, në mënyrë që të arrihet një koordinim dhe kuptim sa më i mirë nga të gjithë.

Hapi 5: Sigurimi i mbështetjes dhe përkrahjes nga aktorët lokalë në territorin ku ndodhet prona e përzgjedhur në bashkëpunim me Agjencinë

Pasi është përzgjedhur prona e konfiskuar, në këtë fazë të procesit duhet të bëhet ndarja dhe diskutimi i idesë me aktorët lokalë, bashkëpunimi me të cilët është shumë i rëndësishëm për zhvillimin dhe zbatimin e saj. Sigurimi i mbështetjes nga ana e tyre do të lehtësojë punën tuaj dhe do të kontribuojë në rritjen e besimit dhe përkrahjes edhe nga ana e komunitetit. Ndër aktorët më të rëndësishëm pavarësisht natyrës së idesë, mund të përmendim:

- **Bashkia.** Bashkia në territorin e të cilës organizata do të zhvillojë idenë në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar është një ndër aktorët kryesorë që duhet të përfshihet që në fazën e zhvillimit të idesë. Krijimi i marrëdhënieve me bashkinë do të ndihmojë në identifikimin e nevojave që do të adresohen nëpërmjet aktivitetit tuaj, identifikimin dhe referimin e grupeve të disavantazuara dhe të prekuara nga aktiviteti kriminal që do të jenë përfituesit kryesorë të sipërmarrjes sociale, në krijimin e lehtësirave për sigurimin e lejeve të nevojshme nga bashkia dhe institucionet e varësisë, për të siguruar përkrahje institucionale gjatë zbatimit të projektit dhe për të përçuar mesazhe mbështetëse në komunitet.

- **Policia e Shtetit.** Edhe pse policia e shtetit nuk ka një rol të veçantë në mbrojtjen e sigurisë fizike të pronës, si një institucion që ka për mision të punës së saj garantimin e një mjedisi të sigurt për komunitetin, është një strukturë e rëndësishme me të cilën duhet të vendoset një marrëdhënie institucionale bashkëpunuese. Përkrahja dhe mbështetja e policisë krijon një ndjenjë sigurie te qytetarët se tashmë prona e konfiskuar i përket shtetit dhe komunitetit.

E RËNDËSISHME!

Është shumë e rëndësishme që vizita të kryhet me praninë e administratorit të pronës, jo vetëm për të siguruar aksesin në pronë, por edhe për të shmangur çdo kontakt dhe diskutim të mundshëm me ish-pronarët e pronës, apo aktorë të tjerë të interesuar.

Duhet të përfshini në vizitë edhe një inxhinier apo arkitekt që do t'ju asistojë në përgatitjen e projektit dhe do të realizojë përshtatjen e infrastrukturës së pronës në përputhje me projekt idenë tuaj. Kjo është mjaft e rëndësishme, pasi restaurimi i pronave të konfiskuara është një ndër zërat e rëndësishëm financiar në projektin që do të zhvillohet i cili lidhet ngushtësisht me kushtet fizike të pronës dhe me nevojat për t'u përshtatur me idenë e sipërmarrjes që do të zhvillohet në të.

Që në këtë fazë duhet të bëhet një vlerësim i kujdesshëm i disa elementëve të rëndësishëm me ndikim financiar, si: amortizimi i pronës, detyrimet ndaj palëve të treta (borxhet e trashëguara), lidhja me rrjetin elektrik dhe atë të ujësllës kanalizimeve, aksesit fizik për përfituesit dhe grupet e synuara (p.sh. personat me aftësi të kufizuara fizike).

Në varësi të natyrës së projektit që do të zbatohet në pronën e konfiskuar dhe grupet me të cilat do të punohet, institucione të tjera lokale me të cilat mund dhe duhet të krijohen marrëdhënie bashkëpunimi janë: institucionet arsimore, shërbimi i provës, etj.

E RËNDËSISHME!

Kjo është një praktikë e re për të gjithë, prandaj duhet të jeni të përgatitur për hezitime dhe refuzime. Duke qënë pjesë e komunitetit të prekur nga aktiviteti kriminal ndaj të cilit është konfiskuar prona, përfaqësuesit e institucioneve lokale mund të mos jenë të gatshëm të ofrojnë bashkëpunimin dhe përkrahjen e tyre të menjëhershme ndaj iniciativës. Duhet të jeni sa më bindës dhe të përgatitur për të adresuar çdo hezitim apo shqetësim të tyre, dhe me projektin tuaj të prodhoni përfitime direkte dhe konkrete të cilat adresojnë nevojat reale të komunitetit.

Hapi 6: Përgatitja e projekt propozimit të plotë

Pasi është identifikuar prona që është më e përshtatshme për zbatimin e projekt idesë, fillon puna për zhvillimin e projektit të plotë, i cili duhet t'i paraqitet Agjencisë për shqyrtim dhe miratim. Disa elementë që duhet të mbahen në konsideratë gjatë përgatitjes së një projekti që do të zbatohet në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar janë:

- Projekti duhet të ketë në fokus të tij mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave apo personave në risk për t'u prekur nga krimi i organizuar, në përputhje me vendimin Nr. 632, datë 23.7.2010;
- Projekti duhet të synojë edukimin, punësimin dhe integrimin në shoqëri të viktimave apo personave në risk për t'u prekur nga krimi i organizuar;
- Projekti duhet të zhvillojë aktivitete që promovojnë mobilizimin e komunitetit dhe angazhimin qytetar në luftën ndaj krimit të organizuar;
- Projekti duhet të promovojë kulturën e ligjshmërisë dhe shtetit të së drejtës, respektimit të të drejtave të njeriut dhe luftën ndaj krimit të organizuar;
- Në projekt duhet të parashikohen kosto për rehabilitimin e infrastrukturës së pronës së konfiskuar nga krimi i organizuar;
- Projekti duhet të përfshijë edhe një plan biznesi i cili jep informacion mbi aktivitetin ekonomik që do të zhvillohet në pronën e konfiskuar;
- Projekti duhet të hartohet për një periudhë kohore për të cilën do të dakordësohet me agjencinë.

Ju duhet të hartoni një plan biznesi gjithëpërfshirës, i cili duhet të ketë të përcaktuar qartë:

- Produktin/shërbimin që do të zhvillohet në sipërmarrjen sociale, që lidhet me qëllimin financiar të saj, në përmbushje të objektivave sociale;
- Planin se si do të përmbushen qëllimet (sociale dhe financiare);
- Klientët potencialë dhe si planifikoni t'i arrini ata;
- Kanalet e komunikimit që planifikoni të përdorni për të përçuar mesazhin publik lidhur me qëllimet sociale të sipërmarrjes sociale;
- Kanalet e marketingut që planifikoni të përdorni për të zhvilluar aktivitetin ekonomik të sipërmarrjes sociale;
- Planin e operacioneve (ku do të bazohet, kush është në ekipin tuaj?);
- Planin financiar (kostot fillestare, të ardhurat e parashikuara, shpenzimet dhe fluksi i parave);
- Aftësitë e kërkuara dhe personelin e nevojshëm.

E RËNDËSISHME!

Agjencia nuk ka një format standard për hartimin e projekt propozimit. Por, ai duhet të përmbajë elementët kryesorë të një projekti, si: qëllimi i projektit, objektivat e projektit, rezultatet e pritshme, aktivitetet kryesore, plani i punës, buxheti[7].

Meqënëse prona e konfiskuar do të përdoret për zhvillimin e një sipërmarrje sociale, projekti duhet të shoqërohet me një plan biznesi[8] për zhvillimin e aktivitetit ekonomik. Proçesi i hartimit të planit të biznesit duhet të jetë gjithëpërfshirës me kontribute nga të gjithë aktorët e përfshirë.

Duhet të mbani parasysh se nuk ekziston një model ideal biznesi ndaj plani duhet të jetë i rivlerësueshëm gjatë zbatimit të tij. Përfshirja e stafit në hartimin e planit të biznesit u jep atyre mundësinë të njihen me objektivat dhe mjetet e nevojshme për zbatimin e tij.

Kuadri ligjor nuk parashikon një afat kohor minimal apo maksimal për dhënien në përdorim të pronës së konfiskuar, por për të siguruar qëndrueshmërinë e aktivitetit dhe shërbimeve që do të ofrohen nga sipërmarrja sociale rekomandohet që afati minimal i kohëzgjatjes fillestare të projektit të jetë jo më pak se 5 vjet.

Agjencia nuk ka asnjë detyrim për mbështetje financiare ndaj organizatës që do të zbatojë idenë në një pronë të konfiskuar. Është detyrim i organizatës që të sigurojë fondet e nevojshme për investimin fillestar si dhe mbështetjen financiare të sipërmarrjes sociale për gjithë kohëzgjatjen e propozuar të projektit.

[7] Shtojca A: Një format projekti i propozuar nga Partnerët Shqipëri

[8] Shtojca B: Një format plan biznesi i propozuar nga Partnerët Shqipëri

Hapi 7: Paraqitja e projektit dhe kërkesës zyrtare pranë Agjencisë për marrjen në përdorim të pronës së konfiskuar

Në përputhje me vendimin Nr. 632, datë 23.7.2010, për procedurën e dhënies në përdorim të pronës së konfiskuar, përfituesi duhet të paraqesë një kërkesë, ku të përcaktohet shprehja e interesit të motivuar e të argumentuar. Kërkesa duhet të shoqërohet nga projekt propozimi i plotë. Agjencia shqyrton kërkesën dhe ia përcjell propozimin në mbledhjen e rradhës Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar. Bazuar në raportin e vlerësimit tekniko-financiar të pasurisë dhe në rekomandimet e Agjencisë, Komiteti merr vendimin për dhënien në përdorim të pronës së konfiskuar.

Komiteti mbledhet sa herë të jetë e nevojshme, me kërkesë të njërit prej anëtarëve ose të Agjencisë, por jo më pak se një herë në tre muaj.

Hapi 8. Firmosja e kontratës me Agjencinë[9]

Nëse kërkesa juaj aprovohet nga Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar, përgatitet dhe firmoset kontrata midis organizatës dhe Agjencisë, e cila përcakton të drejtat dhe detyrimet e të dyja palëve lidhur me përdorimin e pronës së konfiskuar dhe ushtrimin e veprimtarisë që do të zhvillohet në të. Agjencia mbikqyr veprimtarinë e organizatës në përdorimin e pronës së konfiskuar, e cila duhet të raportojë te Agjencia sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në kontratën e përdorimit të pasurisë së konfiskuar.

E RËNDËSISHME!

Agjencia nuk shpall thirrje për organizatat jofitimpurëse për dhënien në përdorim të pronave të sekuestruara apo të konfiskuara, ndaj duhet të jenë vetë organizatat që duhet të shprehin interesin e tyre me projekt ide konkrete.

Ju mund të ftoheni nga Komiteti të merrni pjesë në mbledhjen në të cilën do të shqyrtohet kërkesa juaj, për të prezantuar dhe mbrojtur projektin që keni paraqitur.

E RËNDËSISHME!

Sigurohuni që në datën e hyrjes në fuqi të kontratës, prona të mos ketë asnjë detyrim të papaguar ndaj operatorëve të tretë (OSSHE, UKT, telefoni fikse, etj). Detyrimet e mëparshme të kësaj natyre duhet të shlyhen nga Agjencia, e cila ka në përgjegjësi administrimin e saj.

Nuk mund të ndryshohet objekti i veprimtarisë së përdorimit të pronës së konfiskuar, i përcaktuar në projektin e paraqitur në Agjenci dhe i vendosur në kontratën e firmosur midis palëve, pa miratimin e Agjencisë.

Prona e konfiskuar merret në përdorim pa pagesë për një periudhë të përcaktuar, sipas dakordësisë me AAPSK, me mundësi shtyrje nëse sipërmarrja rezulton e suksesshme. Pas mbarimit të marrëdhënieve kontraktuale me Agjencinë, investimi kapital që bëhet në pronë i mbetet shtetit.

[9] Shtojca C: Kontrata tip me AAPSK

Hapi 9. Ngritja e sipërmarrjes sociale

Pas nënshkrimit të kontratës me AAPSK, ju lind e drejta për fillimin e punës për ngritjen e sipërmarrjes sociale.

Për çdo ndryshim infrastrukturor që do të kryeni në pronën që është dhënë në përdorim, duhet të vihet në dijeni Agjencia, e cila aprovon dhe më pas monitoron ndryshimet infrastrukturale në përfundim të tyre. Në rast se bëhen ndërhyrje madhore infrastrukturale të paautorizuara apo shkaktohen dëmtime të rënda fizike në pronë nga marrësi në përdorim, Agjencia ka të drejtë të kërkojë kthimin e menjëhershëm të pronës.

Agjencia ka të drejtë të inspektojë në çdo moment, edhe pa njoftim paraprak, aktivitetin që kryhet në pronën e konfiskuar të dhënë në përdorim për të verifikuar që objekti po përdoret në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kontratë. Agjencia mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të pronës në rast se ndryshohet destinacioni i përdorimit të saj.

E RËNDËSISHME!

Duhet të jeni të përgatitur për kontakte apo shqetësime të mundshme nga ish-pronarët e pronës së konfiskuar. Për çdo rast kontaktoni menjëherë dhe raportoni rastin në AAPSK. Është detyrim i AAPSK që të adresojë çështjet e konflikteve të mundshme me ish pronarët pranë autoriteteve ligjzbatuese gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Pas fillimit të aktivitetit ekonomik të organizatës në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar, mund të aplikoni pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për marrjen e statusit të Ndërmarrjes Sociale^[10] për të përfituar nga Fondi për Ndërmarrjet Sociale dhe lehtësi të tjera që mund të ofrojë ky status.

Merrni informacionin e duhur lidhur me nevojën për leje nga bashkia apo institucionet e tjera përgjegjëse, para se të filloni kryerjen e punimeve infrastrukturale në pronë. Planifikoni kohën e nevojshme për marrjen e tyre në projekt propozim!

[10] Për më tepër informacione në lidhje me paketën ligjore mbi përfitimin e statusit të sipërmarrjes sociale vizitoni linkun <http://partnersalbania.org/News/paketa-ligjore-mbi-ndermarrjet-sociale-ne-shqiperi/>

5. *SIPËRMARRJET E PARA SOCIALE* TË NGRITURA NË SHQIPËRI NË PRONA TË KONFISKUARA NGA KRIMI I ORGANIZUAR

KeBuono është një pastiçeri sociale që zhvillon veprimtarinë e saj në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar në Fier. Ajo ofron një shumëllojshmëri produktesh si dhe një seri aktiviteteve integruese me fëmijë dhe prindër, adoleshentë, studentë, gra dhe vajza duke synuar ndërtimin në komunitet të një kulture të ligjshmërisë dhe kundër dhunës.

KeBuono ofron trajnime të formimit dhe aftësimit profesional për të rinjtë që janë ish të dënuar ose për familjet e të burgosurve aktualë që përballen me kushte të vështira jetese. Duke kombinuar elementë të ndryshëm, si: punësimi i njerëzve në nevojë dhe promovimi i vlerave dhe të drejtave brenda komunitetit, adresimi i konfliktit shoqëror për shkak të krimit të organizuar, KeBuono! kontribuon në kapërcimin e dyshimeve mbi ripërdorimin e pronave të konfiskuara nga krimi i organizuar në qytetin e Fierit.

Për më tepër informacione vizitoni linkun:

<http://partnersalbania.org/News/permbledhje-projekteve-te-mbeshtetura-permes-cause/>

Garazhi Social i Artizanatit është një punishte e ngritur në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar në Sarandë, ku gra dhe vajza – viktimat apo në rrezik nga krimi i organizuar, trafikimi dhe dhuna në familje - prodhojnë punime artizanale duke përdorur gurët e detit (shumëngjyrësh, njëngjyrësh, të sheshtë, shkëmb, qelqi, etj.). Gurët ngjyrosen, shpohen, gdhenden dhe punohen duke krijuar produkte të ndryshme të gatshme për treg. Modelet e punimeve ndërlidhen me trashëgiminë kulturore dhe folklorin duke i bërë këto produkte unike, të vlefshme dhe konkurruese në tregun artizanal, në mënyrë që të sigurohet gjenerimi i të ardhurave në nivel afatgjatë. Duke i dhënë një fytyrë të re pronës së konfiskuar, sipërmarrja përçon një mesazh të fuqishëm mbi vlerën që ka ri-përdorimi i këtyre aseteve në mbështetje të përfshirjes sociale dhe zhvillimit të ekonomisë lokale.

Për më tepër informacione vizitoni linkun:

<http://partnersalbania.org/News/permbledhje-projekteve-te-mbeshtetura-permes-cause/>

KinFolk Coffee Library është një iniciativë e ngritur në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar në Durrës, duke e transformuar atë në një mjedis miqësor për të rinjtë, veçanërisht ata që janë në rrezik ndaj kriminalitetit të të miturve, familjet e tyre dhe qytetarët. Duke i angazhuar ata në nisma sociale, kulturore dhe edukuese, Kinfolk shërben si një masë parandaluese ndaj përfshirjes së të rinjve në aktivitete kriminale. Kinfolk Coffee Library është një qendër multifunktionale ku të rinjtë mund të takohen, të përfitojnë nga një gamë e gjerë trajnimesh, kursesh mësimore dhe aktiviteteve socio-kulturore dhe të kalojnë kohën e lirë. Kinfolk shërben si një vend për punësim, ri-integrim dhe pasurim të jetës shoqërore të të rinjve, pjesë e shërbimit të provës. Kinfolk Coffee Library është e hapur për të gjitha organizatat, shkollat, institucionet dhe aktorë të tjerë që dëshirojnë të zhvillojnë aktivitete të tyre në këtë mjedis.

Për më tepër informacione vizitoni linkun:

<http://partnersalbania.org/News/permbledhje-projekteve-te-mbeshtetura-permes-cause/>

6. *SHEMBUJ TË SIPËRMARRJEVE SOCIALE TË* NGRITURA NË PRONA TE KONFISKUARA NGA KRIMI I ORGANIZUAR NË ITALI

LA FORZA DEL SILENZIO dhe LFS GLOBAL CARE janë dy sipërmarrje sociale të ngitura në dy prona të konfiskuar në zonën e Caserta-s nga organizata “La Forza Del Silenzio”, një organizatë e themeluar nga prindër të fëmijëve me çrregullim të spektrit autik, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së këtyre fëmijëve. Në dy sipërmarrjet sociale ofohen shërbime specifike që shërbejnë për rehabilitimin dhe integrimin në punë të fëmijëve me çrregullim të spektrit autik përmes zbatimit të projekteve laboratorike në mjedise të mbrojtura. Një ndër aktivitetet i quajtur Farinò, përqëndrohet në prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e produkteve pa gluten, dhe mundëson përfshirjen e fëmijëve në disa faza të zhvillimit të produkteve me praninë e një mbikëqyrësi, me qëllim integrimin e mëtejshëm të tyre në tregun e punës. Një tjetër iniciativë është ajo e quajtur “Everythink”, si pjesë e të cilit është krijuar një laborator i serigrafisë artizanale me qëllim zhvillimin e një pune artizanale dhe kreative, nëpërmjet stampimit serigrafik dhe dixhital në veshjet sportive, në të cilën punësohen dhe ofrohen kurse profesionale për personat e disavantazuar.

Për më tepër informacione vizitoni linkun:

<https://www.laforzadelsilenzio.it/>

"Le Terre di don Peppe Diana" (Tokat e don Peppe Diana) - Kooperativa Sociale “Liberia Terra” u krijua në 20 Shtator 2010 në nder të Don Peppe Diana, prifti që kurrë nuk u përkul para dhunës mafioze deri në ditën kur u vra në kishën e tij në Casal di Principe, në 19 Mars 1994. Është sipërmarrja që administron numrin më të madh të pronave të konfiskuara në Campania, me rreth 80 hektarë tokë, 3 ndërtesa dhe një fabrikë djathi, të shpërndara në pesë bashki të ndryshme në provincën e Caserta-s. Gruri i rritur në një pjesë të tokave të konfiskuara përpunohet në miell, i cili më pas përdoret për të përgatitur makaronat "Paccheri di don Peppe Diana" ("paccheri" janë një lloj makaronash tradicionale napolitane). Produktet e tjera bujqësore që prodhohen në toka të konfiskuara, dërgohen pranë Liberia Terra Mediterranean Consortium[11], e cila bashkon produktet që vijnë nga gjithë Italia, të prodhuara nga sipërmarrje që përdorin asetet e konfiskuara nga krimi i organizuar, duke krijuar produktet që mbajnë markën Liberia Terra.

Për më tepër informacione vizitoni linkun:

<https://www.facebook.com/comitatodonPeppeDiana/>

NCO - "Nuova Cooperazione Organizzata" (Bashkëpunimi i Ri i Organizuar), është krijuar si një veprimtari sipërmarrëse inovative, një laborator që hulumton në mënyrë të vazhdueshme dhe zhvillon mënyra të reja për të shndërruar dhe shitur produktet lokale e veçanërisht ato që vijnë nga tokat e konfiskuara nga krimi i organizuar. Sipërmarrja ofron gjithashtu shërbime hotelerie, restorant dhe piceri (Nuova Cucina Organizzata), ngritur në prona të konfiskuara, me vlerën e shtuar të punësimit të personave të disavantazuar. Emri përmban një provokim dhe një sfidë: në vitet 80 në Campania akronimi N.C.O “Nuova Camorra Organizzata” (Kamora e re e organizuar) ishte sinonim i një realiteti që u organizua për të varfëruar territoret, sot akronimi N.C.O është sinonim i një realiteti që vetë-organizohet për të rikthyer të drejtat, dinjitetin dhe të ardhurat e komunitetit lokal. Realizimi i këtij projekti ka dëshmuar të jetë një faktor i ndryshimit shoqëror që lejon zhvillimin e një ekonomie sociale që promovon produktet tipike të zonës, ato të mallrave të konfiskuara nga krimi i organizuar dhe që krijojnë vende të reja pune për njerëzit e disavantazuar.

Për më tepër informacione vizitoni linkun:

<http://www.ncocucina.com/ncocn/referer/100/idPage/101/lang/it/Come-nasce-la-Nuova-Cucina-Organizzata-.htm>

Made in Castel Volturno

Një sipërmarrje sociale e ndërtuar në vitin 2010 në një pronë të konfiskuar nga Camorra, emri i së cilës karakterizon dimensionin e saj të bazuar në vlera, konsiston në një rrobaqepësi etnike e drejtuar nga një grup grash dhe vajzash afrikane që bëjnë krijime të modës italiane duke përdorur pëlhura afrikane. Këto gra i dhanë jetë një marke të re të modës të quajtur "Made in Castel Volturno". Castel Volturno është një qytet që zakonisht njihet si një vend ku droga, prostitucioni dhe degradimi urban, social dhe kulturor janë shumë të pranishëm, dhe ku prania masive e emigrantëve afrikanë llogaritet si shkak i çdo problemi shoqëror. Mundësia e të bërit modë duke vlerësuar rëndësinë e pasurisë ndërkulturore vjen për të kundërshtuar imazhin e të huajit si armik, duke e bërë atë një burim ekonomik dhe kulturor për zhvillimin e të gjithë komunitetit. Në dritën e kësaj strategjie që synon të transformojë referencën simbolike të vendeve dhe realiteteve, projekti është emërtuar "Le të veshim lirinë".

Për më tepër informacione vizitoni linkun:

<http://www.coopaltriorizzonti.it/la-cooperativa/>

[11] <http://www.liberaterra.it/flex/cm/pages/ServeBLOB.php/L/IT/IDPage/7>

Shtojca

Shtojca A: Forma e projekt propozimit*

Plotësoni formularin e aplikimit sipas udhëzimeve të përfshira në çdo seksion.

1. Informacione të përgjithshme për Aplikantin dhe Bashkë-aplikantin (nëse ka)

Aplikanti	
Emri i organizatës: Statusi ligjor i organizatës (shoqatë, qendër, apo fondacion): Numri i Regjistrimit: Data e Regjistrimit: Vendi i Regjistrimit: Misioni i organizatës: Informacionet e Kontaktit: - Adresa Postare - Telefon/Faks - E-mail - Faqe website Personi i kontaktit: - Pozicion - E-mail - Telefon	
Bashkë-aplikanti (nëse ka)	
Emër i organizatës: Numri i Regjistrimit: Data e Regjistrimit: Vendi i Regjistrimit: Informacionet e Kontaktit: - Adresa Postare - Telefon/Faks - E-mail - Faqe website	

2. Përshkrimi i projektit

Plotësoni tabelën e mëposhtme, e cila duhet të jetë jo më shumë se 1 faqe.

Titulli i Projektit	<i>Titulli i projektit duhet të jetë i shkurtër, konciz dhe i lidhur me objektivat dhe/ose aktivitetet e projektit</i>
Zona e zbatimit të Projektit	<i>Specifiko rajonin (et), zonën (at) ose qytetin (et) që do të përfitojnë nga projekti</i>
Kohëzgjatja totale e projektit	<i>Specifiko kohëzgjatjen e projektit në muaj</i>
Buxheti total i projektit	<i>Përfshini shumën në LEK</i>
Objektivat e projektit	<i>Objektivi i Përgjithshëm Objektiva Specifikë</i>
Grupi (et) e synuar/a ¹²	<i>Përfshini dhe përshkruani shkurt grupin (et) e synuar</i>
Përfituesit përfundimtarë ¹³	<i>Përfshini dhe përshkruani shkurt përfituesit përfundimtarë.</i>
Rezultatet e Pritshme	<i>Përfshini dhe përshkruani shkurt rezultatet e pritshme.</i>
Aktivitetet Kryesore	<i>Përfshini dhe përshkruani shkurt aktivitetet kryesore.</i>

3. Projekt Propozimi (12 faqe)

Projekt propozimit duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- a) Analiza e nevojës dhe mundësive të rëndësishme për fushën e ndërhyrjes dhe zbatimit të propozuar. Referenca në legjislacionin, strategjitë dhe/ose planet përkatëse në nivel kombëtar, rajonal dhe/ose lokal dhe përshkrimi se si propozimi do të lidhet me planet e tilla.
- b) Përshkrimi i projektit përfshirë objektivin e përgjithshëm si dhe metodologjinë e propozuar të zbatimit.
 - Nëse projekti i propozuar është vazhdim i një ndërhyrje të mëparshme ose në vazhdim, tregoni qartë se si synohet të realizohet mbi aktivitetet/rezultatet e ndërhyrjes së mëparshme.
 - Nëse projekti i propozuar është pjesë e një programi më të madh, sqaroni qartë se si përshtatet ose është koordinuar me atë program ose ndonjë projekt tjetër të planifikuar (a dhe b janë të zbatueshëm për ndërhyrjet e zbatuara nga organizata juaj ose organizatat / entitetet e tjera).
- c) Rezultate të qarta, të matshme dhe të arritshme të projektit që sigurojnë përmbushjen e objektivit të projektit të propozuar;
- d) Renditni dhe përshkruani aktivitetet e propozuara, përfshirë informacionin mbi kornizën kohore, metodën e zbatimit dhe ndërlidhjet. Në rast partneriteti, shtjelloni rolin e partnerit;
- e) Paraqitni përfituesit kryesorë/grupet e synuara dhe përfituesit përfundimtarë të projektit, përfshirë përshkrimin e përfitimit të tyre nga ndërhyrja e propozuar. Kur është e mundur, duhet të sigurohen të dhëna mbi shpërndarjen e përfituesve sipas gjinisë dhe grupit nën përfaqësues.
- f) Palët e interesuara të projektit dhe shpjegimi i rolit të tyre në zbatimin e projektit.
- g) Prezantim i shkurtër i planit të monitorimit dhe indikatorëve të propozuar për të matur cilësinë e zbatimit dhe afatin kohor.
- h) Rreziqet e mundshme që mund të kenë një ndikim negativ në zbatimin e projektit së bashku me mundësinë e shfaqjes (të lartë, të mesëm ose të ulët) dhe masave lehtësuese të propozuara.
- i) Metodologjia e propozuar për vizibilitetin e projektit.
- j) Mundësia për përsëritje dhe zgjerim të aktiviteteve.

[12] "Grupet e synuara" janë ato grupe/entitete që do të përfitojnë direkt nga aktivitetet e projektit.

[13] "Përfitues përfundimtarë" janë ata që do të përfitojnë nga projekti në afatgjatë në nivel shoqërie ose sektori.

4. Plani i aktiviteteve

Aktivitetet e përshkruara në planin e veprimit duhet të përputhen me ato të përshkruara në pikën d) të seksionit 3.

Plani i veprimit mund të hartohet duke përdorur formatin e mëposhtëm: **PLANI I AKTIVITETEVE**

5. Kuadri Logjik

Zhvilloni kuadrin logjik të projektit sipas formatit të mëposhtëm: **KUADRI LOGJIK**

6. Buxheti

Plotësoni buxhetin e projektit sipas formatit të mëposhtëm: **BUXHETI**

7. Informacion rreth aplikantit dhe bashkë-aplikantit (nëse ka)

- Përshkruani shkurtimisht dhe qartë strukturën e brendshme të organizatës, kapacitetet teknike dhe infrastrukurore dhe sistemet e menaxhimit financiar dhe administrativ (maksimumi 1 faqe)
 - Përshkruani eksperiencën në zbatimin e projekteve në tre vitet e fundit (duke përfshirë titullin e projektit, periudhën e zbatimit, qëllimin e projektit, rezultat e arritura, përfituesit kryesorë, buxhetin, dhe donatorët (maksimumi 1 faqe për çdo projekt).
-

KUADRI LOGJIK

Kuadri Logjik		
Emri i organizat/ës/ave	Shkruani emrin e organizatës	
Titulli i Projektit dhe vendndodhja e zbatimit	Shkruani emrin e projektit	Shkruani vendndodhjen e zbatimit
Personi i kontaktit dhe Informacionet e kontaktit	Emri Mbiemri	Email / Tel
Buxheti	Shuma totale e buxhetit	

A.

Nr.	Objekti i përgjithshëm	Përfituesit e targetuar
1	Shkruani objektivin e përgjithshëm të projektit	Specifikoni përfituesit kryesorë/grupet e targetuara dhe përfituesit përfundimtar

B.

Nr.	Rezultatet e Projektit	Grupi i targetuar i përfituesve	Mjetet e verifikimit	Risqet (nëse ka)	Vizibiliteti
1	Specifikoni rezultatet e projektit	Specifikoni përfituesit kryesorë/grupet e targetuara	Specifikoni mjetet e verifikimit për arritjen e rezultatit	Listoni risqet potenciale që mund të impaktojnë arritjen e rezultatit të projektit	Specifikoni veprimet që duhet të ndërmerren në mënyrë që të sigurohet vizibiliteti
2					
3					

C.

Nr.	Titulli i Aktivitetit	Përshkrimi i aktivitetit	Mjetet e verifikimit	Linja e buxhetit për këtë aktivitet	Referenca tek rezultatet e projektit
1	Aktiviteti	Përshkruani përmbajtjen e aktivitetit	Specifikoni mjetet e verifikimit (psh. Lista e pjesëmarrësve, agjenda, fotot, videot, publikimet, analizat, raportet, takimet etj.)	Shkruani numrin e linjave të buxhetit të nevojshme për të zbatuar këtë aktivitet	Shkruani numrin e rezultateve të pritura të projektit (1,2,3.....) të lidhura me këtë aktivitet
2					
3					
4					
5					
6					

BUXHETI

Buxheti						
Emri i organizatës dhe akronimi						
Titulli i projektit						
Personi i kontaktit dhe informacionet e kontaktit (email dhe tel.)						
Totali i buxhetit		-				
Nr.	Kategoria	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi	Shuma totale	Justifikimi
1.0 Burimet njerëzore						
1.1	Pozicioni në projekt	muaji	vendosni pagën bruto		Vlera	Shpjegoni përgjegjësitë dhe % e pagës nga ky projekt
1.2						
1.3						
Nëntotali për burimet njerëzore						
2.0 Aktivitetet- Shpenzimet direkte të projektit						
2.1	Aktiviteti 1					
2.1.1	Shpjegoni nën aktivitetet	Specifikoni njësinë				
2.1.2	Shpjegoni nën aktivitetet					
2.1.3	Shpjegoni nën aktivitetet					
2.2	Aktiviteti 2					
2.2.1	Shpjegoni nën aktivitetet					
2.2.2	Shpjegoni nën aktivitetet					
2.2.3	Shpjegoni nën aktivitetet					
2.3	Aktiviteti 3					
2.3.1	Shpjegoni nën aktivitetet					
2.3.2	Shpjegoni nën aktivitetet					
2.3.3	Shpjegoni nën aktivitetet					
2.4	Aktiviteti 4					
2.4.1	Shpjegoni nën aktivitetet					
2.4.2	Shpjegoni nën aktivitetet					
2.4.3	Shpjegoni nën aktivitetet					
Nëntotali për aktivitetet						
3.0 Kostot Administrative dhe kostot e zyrës (tarifat bankare, qera, shpenzimet utilitare, komunikimi, udhëtimet lokale, materiale zyre)						
3.1		muaji				Justifikoni këto shpenzime
3.2		muaji				Justifikoni këto shpenzime
3.3		muaji				Justifikoni këto shpenzime
3.4		muaji				Justifikoni këto shpenzime
3.5		muaji				Justifikoni këto shpenzime
Nën totali për kostot administrative						
TOTALI I PROJEKTIT						
4.0	Auditi					
4.1	Kostot e auditit (për tu llogaritur si përqindje e nëntotalit të projektit)					
KOSTOT TOTALE TE PROJEKTIT						

Shtojca B: Modeli i planit të biznesit për Sipërmarrjet Sociale*

PËRMBAJTJA

B.2	Përmbledhja ekzekutive	B.7	Shpenzimet mujore
B.2	Mundësitë	B.8	Fitimi/Humbja neto për vit
B.2	Adresimi i problemit	B.8	Llogaritë
B.2	Zgjidhja e problemit	B.8	Fitimet dhe Humbjet e Projektuara.
B.2	Tregu		
B.2	Konkurentët		
B.2	Përse ne?		
B.2	Pritshmëritë		
B.2	Parashikim		
B.2	Treguesit financiarë për vitin		
B.3	Financimi i nevojshëm		
B.4	Mundësitë		
B.4	Problemi & Zgjidhja		
B.4	Problemi që vlen të zgjidhet		
B.4	Zgjidhja		
B.4	Tregu i synuar		
B.4	Madhësia dhe segmentet e tregut		
B.4	Konkurentët		
B.4	Alternativat ekzistuese		
B.4	Avantazhet tona		
B.5	Zbatimi		
B.5	Marketingu & Shitjet		
B.5	Plani i marketingut		
B.5	Plani i shitjeve		
B.5	Operacionet		
B.5	Vendndodhja & Facilitetet		
B.5	Teknologjia		
B.5	Pajisjet & Mjetet		
B.6	Rezultatet & Indikatorët		
B.6	Rezultatet		
B.6	Indikatorët		
B.6	Kompania		
B.6	Përmbledhje		
B.6	Ekipi		
B.6	Ekipi i menaxhimit		
B.6	Këshilluesit		
B.6	Plani financiar		
B.6	Parashikimet		
B.6	Supozimet kryesore		
B.7	Të ardhurat mujore		

Përmbledhja ekzekutive

Mundësitë

Adresimi i problemit

UDHËZIME: Përshkruani shumë shkurt përse sipërmarrja juaj duhet të ekzistojë. Çfarë problemi zgjidhni ju për klientët tuaj?

Zgjidhja e problemit

UDHËZIME: Përmbliidhni shkurtimisht se çfarë bën sipërmarrja juaj. Përmbledhja ekzekutive duhet të jetë shumë e shkurtër dhe mund të shkoni në detaje më vonë në plan.

Tregu

UDHËZIME: Përshkruani klientët tuaj ose segmentet e tregut që ju targetoni. Përsëri, mbajini gjërat shumë shkurtimisht në përmbledhjen ekzekutive dhe shtoni më shumë detaje më vonë në plan.

Konkurentët

UDHËZIME: Përmbliidhni konkurrencën tuaj kryesore. Cilat janë opsionet e klientëve tuaj?

Përse ne?


UDHËZIME: Shkruani një përmbledhje të shkurtër për ju dhe ekipin tuaj. Përse jeni njerëzit e duhur për të ndërtuar këtë sipërmarrje?

Pritshmëritë

Parashikim

UDHËZIM: Shkruani një përmbledhje të shkurtër të synimeve tuaja financiare. Sa planifikoni të shisni në vitin e ardhshëm? Cilat janë qëllimet tuaja afatgjata të shitjes?

Treguesit financiarë për vitin



UDHËZIME: Vendosni një grafik të të dhënave tuaja financiare kryesore këtu.

Financimi i nevojshëm

UDHËZIME: Nëse jeni duke shkruar një plan biznesi për të mbledhur para për biznesin tuaj, përfshini një përmbledhje të shkurtër të asaj që kërkon. Nëse nuk po grumbulloni para ose nuk planifikoni të merrni një hua, mund ta fshini këtë pjesë.



Mundësitë

Problemi & Zgjidhja

Problemi që vlen të zgjidhet

UDHËZIME: Shkruani pak më shumë detaje sesa keni dhënë në Përmbledhjen Ekzekutive për problemin që po zgjidhni. Çfarë u nevojitet klientëve tuaj? A kanë nevojë për një produkt më të mirë, një produkt më të lirë, apo thjesht një dyqan në një vend ndodhje më të mirë? Përshkruani pse klientët do të duan të blejnë nga ju.

Zgjidhja

UDHËZIME: Siguroni detaje shtesë, përtej asaj që keni shkruar në Përmbledhjen Ekzekutive, për produktin ose shërbimin tuaj. Çfarë është unike dhe e veçantë për sipërmarrjen tuaj që do ta dallojë atë nga konkurentët?

Tregu i synuar

Madhësia e tregut dhe Segmentet

UDHËZIME: Përshkruani klientët tuaj kryesorë - cilët janë ata dhe cilat janë karakteristikat e tyre kryesore. Nëse sipërmarrja juaj po synon më shumë se një grup klientësh (të quajtura gjithashtu 'segmente'), përshkruani secilin grup këtu. Nëse mundeni, përfshini detaje në lidhje me sa njerëz janë në secilin segment dhe sa i madh është tregu total.

Konkurentët

Alternativat ekzistuese

UDHËZIME: Përshkruani konkurrencën tuaj aktuale. Cilat produkte dhe shërbime përdorin aktualisht njerëzit?

Avantazhet

UDHËZIME: Shpjegoni pse produkti ose shërbimi juaj është më i mirë se të tjerët. Gjithashtu, sigurohuni që të përshkruani çdo avantazh konkurrues që mund të keni, të tilla si një patentë ose një komponent tjetër unik për biznesin tuaj.

Implementimi

Marketingu & Shitjet

Plani i Marketingut

UDHËZIM: Shpjegoni se si planifikoni të shpërndani informacionin për produktin tuaj në tregun/tregjet tuaj/a të synuar. A do të përdorni reklamat? Sido që të jenë planet tuaja të marketingut, përshkruajini ato këtu.

Plani i shitjeve

UDHËZIM: Nëse sipërmarrja juaj mbështetet te njerëzit për të mbyllur marrëveshjet e shitjeve, keni nevojë për një plan shitje. Plani juaj i shitjeve duhet të shpjegojë se si i shndërroni njerëzit që shprehin interes për produktin ose shërbimin tuaj në klientë që paguajnë.

Operacionet

Vendndodhja & Facilitetet

UDHËZIM: Përshkruani vendndodhjet fizike të sipërmarrjes suaj. Kjo mund të jetë zyra juaj, vendndodhjet e dyqaneve, impiantet prodhuese, objektet e ruajtjes - çdo gjë që është e rëndësishme për biznesin tuaj. Sa hapësirë keni në dispozicion, dhe sa mirë do t'i plotësojë ajo nevojat tuaja aktuale dhe të ardhshme?

Teknologjia

UDHËZIM: Përshkruani ndonjë softuer të rëndësishëm, harduer ose teknologji tjetër të informacionit që përdorni tani ose planifikoni të përdorni më vonë në funksion të sipërmarrjes suaj. Kjo mund të përfshijë një sistem të shitjes për të marrë pagesa, një motor të tregtisë elektronike për faqen tuaj të internetit, një zgjidhje CRM për menaxhimin e operacioneve tuaja, mjetet e marketingut, etj.

Pajisjet & Mjetet

UDHËZIM: Shënoni çdo pajisje që keni ose planifikoni të blini për të bërë punën tuaj. Ky është një komponent i rëndësishëm i planit të biznesit për shumë kompani industriale.

Rezultatet & Indikatorët

Rezultatet

UDHËZIM: Renditni rezultatet e pritshme kryesore dhe datat kur shpresoni t'i realizoni ato. Nëse keni arritur tashmë qëllime kryesore për sipërmarrjen tuaj, renditini ato si dëshmi se sipërmarrja juaj po tërheq vëmendje - me fjalë të tjera, po merr vëmendje pozitive nga klientët e mundshëm.

Indikatorët

UDHËZIM: Shpjegoni cilët indikatorë të performancës janë më të rëndësishëm për të kuptuar se si po performon sipërmarrja juaj. Çfarë do të thotë suksesi për ju dhe si do ta kuptoni kur ta arrini?

Kompania

Përmbledhje

UDHËZIM: Përdorni këtë seksion për të specifikuar se kush është drejtuesi i sipërmarrjes tuaj. Gjithashtu, duhet të identifikoni strukturën ligjore të sipërmarrjes suaj.

Ekipi

Ekipi i menaxhimit

UDHËZIM: Renditni anëtarët e ekipit menaxhues, përfshirë veten. Përshkruani aftësitë dhe përvojën e secilit person dhe çfarë do të bëjnë ata për sipërmarrjen. Eshtë në rregull nëse nuk i keni ende të gjithë për një ekip të plotë menaxhimi. Në atë rast, sigurohuni që të identifikoni boshllëqet në ekipin tuaj që keni në plan të plotësoni me kalimin e kohës.

Këshilluesit

UDHËZIM: Përshkruani çdo mentor, investitor, ish-profesorë, ekspertë të industrisë, miq të njohur ose anëtarët e familjes, këshilltarët e biznesit të vogël ose të tjerë që mund t'ju ndihmojnë si drejtues biznesi.

Plani financiar


Parashikimet

Supozimet kryesore

UDHËZIM: Përshkruani vlerat e vendosura në parashikimin tuaj financiar. A i projektioni të ardhurat tuaja bazuar në rezultatet e kaluara, hulumtimin e tregut, supozimin tuaj më të mirë se sa njerëz ju vizitojnë dhe çfarë përqindje e tyre mund të blejnë, ose ndonjë metodë tjetër? Çfarë lloj rritjeje po supozoni? Cilat janë shpenzimet tuaja kryesore dhe shpenzimet e dukshme? Çfarë niveli të fitimit parashikoni të gjeneroni?


Të ardhurat mujore

UDHËZIM: Përfshini një grafik që tregon të ardhurat tuaja të parashikuara




Shpenzimet mujore

UDHËZIM: Përfshini një grafik që tregon shpenzimet tuaja të parashikuara



Fitimi/Humbja neto për vit

UDHËZIM: Përfshini një grafik që tregon të fitimet/humbjet tuaja të parashikuara



Llogaritë

Fitimet dhe Humbjet e Projektuara

UDHËZIM: Siguroni këtu një përmbledhje të parashikimit tuaj financiar.

	2020	2021	2022
Të ardhurat			
Kostot direkte			
Marzhi Bruto			
Marzhi Bruto %			
Shpenzimet operative			
Rrogat			
Shpenzime të tjera të lidhura me punonjësit			
Shpenzimet totale të funksionimit			
Të ardhurat operative			
Interesi i pësuar			
Zhvlerësimi dhe amortizimi			
Taksa mbi të ardhurat			
Shpenzimet totale			
Fitimi neto			
Fitimi / Shitjet Neto			

Shtojca C: Kontratë tip huapërdorje*

KONTRATË HUAPËRDORJE

Nr _____ Datë ____/____/____

1. Baza Ligjore: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 34/2019 Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, i ndryshuar, Ligji Nr. 10 192, datë 3.12.2009 Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, i ndryshuar, Vendimet e Komitetit Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar.

2. PALËT

Në kuptimin e kësaj kontrate huapërdorje, e cila që këtu dhe më pas referohet si kontratë, palët janë:

2.1 Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, përfaqësuar nga Kryeadministratori Z. [emër / mbiemër], i datëlindjes, lindur në dhe banues në, me shtetësi shqiptare, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me dokument identifikimi - pasaportë nr., referuar në këtë kontratë me cilësinë e HUADHËNËSIT.

2.2 [Emri i organizatës fituese], përfaqësuar nga [përfaqësuesi]..... Z/Znj.[emër / mbiemër], i/e datëlindjes, lindur në dhe banues në, me shtetësi shqiptare, madhor/e, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i/e identifikuar me dokument identifikimi- pasaportë nr....., referuar në këtë kontratë me cilësinë e HUAMARRËSIT.

3. OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është dhënia në përdorim e objektit:

.....

4. DESTINACIONI I PËRDORIMIT TË OBJEKTIT

4.1 Destinacioni i përdorimit të objektit është zbatimi i projektit [emri i projektit] nga organizata [emri zyrtar i organizatës fituese] në bashkëpunim me [emri i organizatës partnere nëse ka]

4.2 Huamarrësi nuk mund të ndryshojë destinacionin e përdorimit të objektit, pa marrë pëlqimin paraprak të Huadhënësit.

5. AFATI I KONTRATËS

5.1 Afati i kësaj Kontrate është një periudhe vjeçare dhe fillon më datë dhe mbaron më datë

5.2 Palët mund të rinegociojnë për zgjatjen e afatit të kësaj Kontrate nën të njëjtat kushte, por Huamarrësi duhet t'i bëjë Huadhënësit një propozim me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara datës së përfundimit të afatit të Kontratës.

5.3 Me mbarimin e afatit Huamarrësi detyrohet të kthejë objektin në gjendjen e kontraktuar në fillim duke përfshirë edhe ndryshimet në infrastrukturë të bëra gjatë periudhës së përdorimit të objektit.

6. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E HUADHËNËSIT

6.1 HUADHËNËSI administrator i ambienteve të përshkruara në pikën 3 të kësaj kontrate jep në huapërdorim ambientet për zbatimin e projektit pa kundërshtim.

6.2 HUADHËNËSI ka të drejtë të inspektojë në çdo çast gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate nëse objekti përdoret në përputhje me këtë Kontratë edhe pa njoftim paraprak.

6.3 HUADHËNËSI ka për detyrim që të japë në huapërdorim pronën e konfiskuar, subjekt i kësaj kontrate, pa asnjë detyrim financiar ndaj operatorëve të tretë (OSSHE, Ujësjetës kanalizime, telefoni fikse, apo të tjerë) në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate (data e hyrjes në fuqi).

6.4 HUADHËNËSI mund të kërkojë kthimin e menjëhershëm të objektit në rast se huamarrësi:

- Ndryshon destinacionin e përdorimit të objektit jashtë qëllimit të përdorimit.
- Nuk shlyen detyrimet ndaj palëve të treta që lidhen me përdorimin e objektit.
- Bën ndërhyrje madhore infrastrukturore të paautorizuara nga Huamarrësi apo shkakton dëmtime të rënda fizike në objekt.
- Në rast se Kontrata zgjidhet për një nga arsyet e sipërpërmendura atëherë Huamarrësi duhet të dorëzojë ambientet brenda një afati 30 (tridhjetë) ditor nga marrja e njoftimit me shkrim nga ana e Huadhënësit.

6.5 HUADHËNËSI ka detyrim të adresojë çështje të konflikteve të mundshme me ish pronarët pranë autoriteteve ligjzbatuese gjatë gjithë periudhës së kësaj kontrate.

7. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E HUAMARRËSIT

7.1 HUAMARRËSI është i detyruar të ruajë dhe ta mbajë objektin me përkujdesje dhe të mos e përdorë atë ndryshe nga përdorimi i caktuar në këtë kontratë.

7.2 HUAMARRËSI ka të drejtë të bëjë ndryshime infrastrukturore në objekt, me aprovim paraprak nga AAPSK.

7.3 HUAMARRËSI është përgjegjës për çdo dëmtim të objektit, përvec rasteve të fatkeqësive natyrore apo forcave madhore (lufta, lufta civile, kryengritje dhe revolucione, fatkeqësi natyrore si stuhi të ndryshme, ciklone, termite) të cilat sjellin shkatërrime të mëdha në mosfunksionimin e jetës së përditshme shoqërore.

7.4 HUAMARRËSI detyrohet të përdorë objektin ashtu si është përshkruar në pikën 4 të kësaj kontrate.

7.5 HUAMARRËSI nuk mund t'ia japë një të treti objektin ashtu si është përshkruar në pikën 4 të kësaj kontrate.

7.6 HUAMARRËSI nuk mund të kërkojë nga Huadhënësi pagimin e shpenzimeve që ka bërë për të përdorur objektin.

7.7 HUAMARRËSI është i detyruar të bëjë me shpenzimet e tij ndreqjet e zakonshme të objektit të dhënë.

7.8 HUAMARRËSI detyrohet të kthejë objektin në të njëjtën gjendje që e ka marrë duke përfshirë edhe ndryshimet e zakonshme të shkaktuara nga përdorimi i tij.

7.9 HUAMARRËSI është i detyruar të mbulojë të gjitha shpenzimet të cilat nuk janë përmendur në kontratë lidhur me objektin e dhënë në huapërdorje.

7.10 HUAMARRËSI në përfundim të kësaj kontrate mund të marrë me vete të gjitha sendet e luajtshme, që nuk janë në pronësi të Huadhënësit, të cilat kanë qenë në funksion të aktivitetit të kryer nga Huamarrësi pa shkaktuar dëmtim të objektit.

7.11 Me mbarimin e afatit të kësaj kontrate HUAMARRËSI dorëzon ambientin, duke shlyer të gjitha detyrimet për shpenzimet e kryera dhe që janë në ngarkim të objektit të marrë në huapërdorim.

8. DISPOZITA TË ZGJIDHJES SË KONFLIKTEVE

8.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Huadhënësit dhe Huamarrësit zgjidhen me marrëveshjen e palëve dhe kur kjo nuk është e mundur, palët kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë.

9. NJOFTIMET

9.1. Të gjitha njoftimet, komunikimet midis palëve në këtë Kontratë do të bëhen më shkrim, duke iu drejtuar personalisht personave përfaqësues ose atyre të ngarkuar me përgjegjësi, në adresën që palët kanë deklaruar në këtë kontratë. (ose në një adresë tjetër që palët ia kanë njoftuar respektivisht njëra –tjetrës).

10. DOKUMENTET BASHKËNGJITUR

Vërtetimi i pronësisë / Kartela

Gentplani i pronës

Ekstrakti i QKR-së së Organizatës _____

Kartat e identitetit të personave që firmosin kontratën

11. NËNSHKRIMI

Kjo Kontratë u hartua në tre kopje me vlerë të njëjtë dhe pasi lexohet nga palët, nënshkruhet me vullnetin e lirë prej tyre. Secila palë merr nga një kopje, dhe një kopje qëndron në arshivën e AAPSK.

PALËT**HUADHËNËSI**

Agjencia për Administrimin e Pasurive të
Sekuestruara dhe të Konfiskuara

KRYEADMINISTRATOR
[EMËR MBIEMËR, firmë]

HUAMARRËSI

[Emri i organizatës]


[PËRFAQSUESI]
[EMËR MBIEMËR, firmë]

Shtojca D: Lista e pronave të konfiskuara nën administrimin e AAPSK në mars 2020

Emërtimi i pasurisë	Njesia	Sasia	Nr. dhe data e vendimit	Dt. e marrjes në dorëzim
Toke are 2930 m2/object, Fshati Rreth Shijak	m2	2930	Nr. 08, datë 14.06.2016	15.07.2015
Toke 2750m2/objekt ndertimi, Fshati Rreth Shijak	m2	2750	Nr. 08, datë 14.06.2016	15.07.2015
Toke 420 m2/oobjekt ndertimi, Rreth Shijak	m2	420	Nr. 08, datë 14.06.2016	15.07.2015
Toke 1485 m2 ne Yzberisht	m2	1485	Nr. 01, datë 01.02.2016	29.10.2015
Podrum me sip 85m2, ZK.8524, Elbasan	m2	85	Nr. 25, datë 23.11.2015	10.12.2015
Toka ne Gjirin e Lalzit me sip. 1515 m2	m2	1515	Nr. 24, datë 30.11.2016	22.02.2017
Toka ne Gjirin e Lalzit 745	m2	745	Nr. 24, datë 30.11.2016	22.02.2017
Apartament 2+1, sip 80 m2 rr.Muhamet Gjollësia.nr,18	m2	80	Nr. 24, datë 30.11.2016	02.03.2017
Apartament 2+1, sip 83 m2 rr.Muhamet Gjollësia.nr.17	m2	83	Nr. 24, datë 30.11.2016	02.03.2017
Njesi biznesi Yzberish 61 m2.	m2	61	Nr. 24, datë 30.11.2016	28.04.2017
Tokë Arë, me sip. 1200 m2, Sauk.	m2	1200	Nr. 24, datë 30.11.2016	16.05.2017
Tokë Arë, me sip. 13.000 m2, Sauk.	m2	13000	Nr. 24, datë 30.11.2016	16.05.2017
Tokë Arë, me sip. 96 m2, Sauk.	m2	96	Nr. 24, datë 30.11.2016	18.09.2017
Tokë Arë, me sip.355 m2, Sauk.	m2	355	Nr. 24, datë 30.11.2016	18.09.2017
Tokë Arë, me nr. 44/88, Marikaj	m2	710	Nr. 24, datë 30.11.2016	19.01.2018
Tokë Arë, me nr. 84/35, Marikaj	m2	1800	Nr. 24, datë 30.11.2016	19.01.2018
Tokë Arë, me nr. 84/32, Marikaj	m2	1231	Nr. 24, datë 30.11.2016	19.01.2018
Pemishte, me nr. 84/60 sip. 260 m2. Marikaj Vore	m2	260	Nr. 24, datë 30.11.2016	19.01.2018
Garazh 48.5 m2 Sarande	m2	48.5	Nr. 10 11.07.2005	09.04.2009
Are me sip.6000 m2, Durres	m2	6000	Nr.4 dt 7.02.2010	23.09.2009
Are me sip.9000 m2, Durres	m2	9000	Nr.4 dt 7.02.2010	23.09.2009
Are me sip.4000 m2, Durres	m2	4000	Nr.4 dt 17.02.2010	23.09.2009
Ullishte me sip. 1500 m2, Shkalnuer , Durres	m2	1500	Nr.4, dt 17.02.2010	23.09.2009
Njësi me sip. 56.84 m2, Orikum, Vlorë.	m2	56.84	Nr.05.dt.16.03.18	18.11.16
Njësi me sip. 78.66 m2, Orikum, Vlorë.	m2	78.66	Nr.05.dt.16.03.18	18.11.16
Njësi me sip.175 m2,Parku"Rr.kavajës",Tiranë.	m2	175	Nr.05.dt.16.03.18	16.12.16
Bodr,(parkimi i hapur)nr.pas.5/56-b2 me sip.11.6 m2,shëngjin.	m2	11.6	Nr.05.dt.16.03.18	30.11.16
Bod,(parkimi i hapur) nr.pas.5/56-b2me sip.11.6 m2,shëngjin.	m2	11.6	Nr.05.dt.16.03.18	30.11.16
Pasuria nr.35/3 toke pyll sip. 364 000 m 2 Fier	m2	364000	nr.8,dt.03.05.2018	10.04.2019
Bar Restorant 500 m2. Bisht Palle, Durres.	m2	500	Nr.5 / 07.04.2011	18.06.10
Ap. me sip.128.6 m2,Vlorë	m2	128.6	Nr.7 / 14.10.2011	13.12.2011
Ap. me sip.124.6 m2, lagja "pavaresia"Vlorë	m2	124.6	Nr.7 / 14.10.2011	13.12.2011
Truall 470m ² dhe ndertim (24 +48) m ² . Lagja Clirimi Lushnje	m2	470	Nr.12 / 06.03.2008	27.12.2010
Truall me sip 110 m ² , ZK, nr 8572,nr pasurie 9/100, lagja "Skender Libohova" , Lushnje.	m2	110	Nr.4 / 25.02.2010	06.11.2011
Pas. e lua. ne "Laguna Karavasta". Divjake , Lushnje (Hekurishte per te dale J/Perdorimi)	cope	1	Nr.12 / 06.03.2008	27.12.2010
Ap me sip 121 m2 ne Durres	m2	121	nr. 58 dt15.05.2017	21/07/2017
Njesi tregtare sip. 110.5 m2. Lagja "Apollonia",qyteti Fier	m2	110.5	nr.10/3.11.2011	06.01.2011
Njesi tregtaresip. 28.1m2 , Lagja "Apollonia",qyteti Fier	m2	28.1	nr.10/3.11.2011	06.01.2011
Lokal me sip 174 m2 ne Rr. "taulantia ,Durres	m2	174	nr. 58 dt15.05.2017	21/07/2017

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Rruga e Elbasanit, N. Park Gate, H. 3 Ap. 71/73, Kutia
Postare 2418/1, 1010, Tiranë, Shqipëri



www.partnersalbania.org